

Lejet e ndërtimit


Tremujori II, 2020

Tiranë, më 31 Gusht 2020: Në tremujorin e dytë 2020 janë miratuar gjithsej 209 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 339 leje të miratuara në tremujorin e dytë 2019, duke shënuar një rënie prej 38,3 %.

Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja, në tremujorin e dytë 2020, është 322.294 m², nga 508.106 m² miratuar në tremujorin e dytë 2019, duke shënuar një rënie prej 36,6 %.

Në tremujorin e dytë 2020, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 14,8 miliardë lekë, nga 18,1 miliardë lekë miratuar në tremujorin e dytë 2019, duke shënuar një rënie prej 18,0 %.

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit , T2 - 2020



Tab.1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T2 – 2020

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m ²	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
Gjithsej			11.757.567	3.077.898
I. Ndërtesa	209	322.294	10.713.447	443.805
1.Ndërtime për banim (rezidente)	136	271.896	9.036.611	334.742
a. Me një kat	45	6.263	188.123	83.606
b. Me dy kate	56	14.289	448.561	189.321
c. Me tre ose më shumë kate	32	231.592	7.653.936	59.891
d. Rezidenca për komunitetet	3	19.752	745.991	1.924
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	73	50.398	1.676.836	109.063
a. Hotele dhe të ngjashme	6	6.969	177.512	0
b. Ndërtesa për zyra	1	164	7.500	33.148
c. Ndërtesa tregtare	20	5.206	186.438	36.736
d. Ndërtesa industriale	21	29.358	905.911	0
e. Ndërtesa të tjera	25	8.701	399.475	39.179
II. Punime Inxhinierike			1.044.120	2.634.093
1. Infrastruktura e transportit; Rrugë e autostrada			766.504	576.172
2. Linjat e ujësjellësave,elektrike dhe telekomunikacionit			274.848	2.045.245
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			0	0
4. Punime të tjera inxhinierike			2.768	12.676

* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	II - 19	III - 19	IV - 19	I - 20	II - 20
Shqipëria	339	308	202	184	209
Berat	6	4	1	4	10
Dibër	2	12	3	2	11
Durrës	55	48	23	12	27
Elbasan	29	21	23	19	24
Fier	20	35	23	15	19
Gjirokastër	7	4	1	4	9
Korçë	22	18	24	16	14
Kukës	6	5	0	1	0
Lezhë	10	16	15	8	12
Shkodër	24	4	16	3	18
Tiranë	140**	123**	66**	84	63
Vlorë	18	18	7	16	2

* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

** Në informacionin e qarikut Tiranë, janë përditësuar të dhënat për tremujorin e dytë, tremujorin e tretë dhe tremujorin e katërt 2019.

Tab.3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	II - 19	III - 19	IV - 19	I - 20	II - 20
Shqipëria	508.106	690.699	241.708	333.645	322.294
Berat	1.856	1.448	98	657	2.868
Dibër	503	5.993	557	260	4.250
Durrës	60.708	34.685	19.422	8.971	12.468
Elbasan	11.847	8.410	5.725	6.047	10.004
Fier	6.928	18.597	8.129	7.257	6.735
Gjirokastër	8.168	1.492	134	4.453	1.576
Korçë	11.322	7.238	10.759	8.112	4.689
Kukës	4.423	4.836	0	115	0
Lezhë	6.062	36.408	32.025	1.923	6.536
Shkodër	11.514	713	3.075	292	8.185
Tiranë	371.691**	562.092**	148.121**	282.916	264.387
Vlorë	13.084	8.787	13.663	12.642	596

* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

** Në informacionin e qarkut Tiranë, janë përditësuar të dhënat për tremujorin e dytë, tremujorin e tretë dhe tremujorin e katërt 2019.

Tab.4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Qarqet	II - 19	III - 19	IV - 19	I - 20	II - 20
Shqipëria	18.085.552	25.791.473	11.744.012	13.375.967	14.835.465
Berat	301.059	83.304	224.810	116.140	913.810
Dibër	84.834	366.053	159.184	12.669	533.248
Durrës	2.309.790	1.190.215	602.812	247.348	1.091.556
Elbasan	1.050.083	802.368	354.759	836.582	879.350
Fier	807.316	1.071.093	1.403.325	625.026	584.484
Gjirokastër	274.051	133.463	17.896	144.851	44.227
Korçë	440.280	252.804	483.100	461.097	156.079
Kukës	195.183	222.348	0	3.122	0
Lezhë	277.277	664.846	964.939	590.569	172.240
Shkodër	421.698	1.065.159	895.028	32.378	322.504
Tiranë	11.173.520**	18.798.476**	5.640.583**	9.709.233	8.891.035
Vlorë	750.461	1.141.344	997.576	596.952	1.246.932

* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstrukcioneve.

** Në informacionin e qarkut Tiranë, janë përditësuar të dhënat për tremujorin e dytë, tremujorin e tretë dhe tremujorin e katërt 2019.

Metodologjia

“Lejet e ndërtimit” është një publikim me frekuencë tremujore i cili ka për qëllim të paraqesë informacion mbi lejet e ndërtimit të miratuara për ndërtesa dhe punimeve inxhinierike në nivel qarku dhe vendi. Informacioni statistikor rreth lejeve të ndërtimit të miratuara është një tregues afatshkurtër i cili paraqet zhvillimin e sektorit të ndërtimit në periudhën pasardhëse.

Treguesit kryesorë të lejeve të ndërtimit të miratuara të cilat paraqiten në këtë publikim janë:

- Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse.

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

Punime Inxhinierike janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.